

## MAQEDONIA TE NJOHE PAVARESINE E KOSOVES

Tetovë, 17 shkurt 2008

Drejtuar:

- Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, z. Branko Crvenkovski
- Kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë, z. Lubisha Georgievski
- Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, z. Nikolla Gruevski

Lënda: Kërkesë për njohjen e Kosovës, shtet sovran dhe të pavarur

Të nderuar zotërinj,

Parlamenti i Kosovës, sot, më 17 shkurt 2008, në seancë të jashtëzakonshme shpalli Kosovën shtet sovran, të pavarur e demokratik.

Ky vendim historik konfirmoi realitetet e reja në rajonin tonë, në Evropë dhe në botë. Respektimi i vullnetit të shumicës dërrmuese të popullit të Kosovës, neve si shtet, na obligon të ndërtojmë qëndrim parimor dhe të ndërmarrim hapa konkret.

Në bazë të këtyre realiteteve të reja, në frymën e fqinjësisë së mirë, në emër të perspektivës evro – atlantike të vendeve tona, në emër të paqes, stabilitetit dhe të ardhmes së rajonit, ne, deputetët e Bashkimit Demokratik për Integrim Ju propozojmë dhe ju ftojme të ndërmerrni të gjitha veprimet e duhura që shteti ynë, Republika e Maqedonisë, të njohë Kosovën shtet sovran dhe të pavarur.

Urojmë që në këto momente vendimtare për vendin tonë dhe shansin historik për marrjen e ftesës në Samitin e Bukureshtit dhe anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, njohja e Kosovës do ta rreshtonte vendin tonë krah për krah Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Shqipërisë dhe shumë shteteve tjera që kanë paralajmëruar njohjen e menjëhershme të Kosovës.

Vlerësojmë se në këto momente historike do të dimë të marrim vendime të guximshme e të drejta, sepse Maqedonia fiton një shtet fqinj me orientime të njëjta sikurse edhe ne, fiton një fqinj mik, aleat dhe partner strategjik në përcaktimet tona të përbashkëta evro-atlantike.

Me respekt,

Deputetët e Bashkimit Demokratik për Integrim në Parlamentin e Maqedonisë:

1. Ali Ahmeti
2. Rafis Aliti
3. Teuta Arifi
4. Fazli Veliu
5. Xhevat Ademi

6. Safet Neziri
7. Sadulla Duraku
8. Tahir Hani
9. Ajshe Selmani
10. Blerim Bexheti
11. Azis Pollozhani
12. Selvie Saliu
13. Agron Buxhaku
14. Zymrete Jakupi